



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Reform
Monitor

KOSOVË

Raport i përditësuar i Agjendës së Reformave

SEMESTRI I 2-TË, 2025



GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES

Raport i përditësuar i Agjendës së Reformave

Semestri i 2-të, 2025

Botues:

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS)

Autori:

Besar Gergi, GLPS

Redaktor:

Stefan Ristovski, Instituti për Politika Evropiane - EPI

Dizajni:

Relativ

Prishtinë, Mars, 2026

Ky botim është financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe Rrjetit Think for Europe, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJE

HYRJE	04
GJETJET DHE REKOMANDIMET KRYESORE	05
MONITORIMI I PROCESIT TË IRR-S	06
MARRËVESHJET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	06
KËRKESAT DHE LËSHIMI I FONDEVE	08
ZBATIMI I AGJENDËS SË REFORMAVE (SEMESTRI 2-TË, 2025)	
REFORMAT NË FOKUS: FUSHA E POLITIKAVE TË MONITORIMIT TË REFORMËS	09
SUNDIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAT THEMELORE	11
REFORMAT GJYQËSORE	11
ANTI KORRUPSIONI	14
TRANZICIONI DIGJITAL	17
SHËRBIMET PUBLIKE DIGJITALE	17
SIGURIA KIBERNETIKE	19
ENERGJIA DHE TRANZICIONI I GJELBËR	20
BURIMET E RIPËRTËRITSHME	20
KAPITALI NJERËZOR	22
ARSIMI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL	22
MJEDISI I BIZNESIT DHE ZHVILLIMI I SEKTORIT PRIVAT	24
NDËRMARRJET SHTETËRORE (NSH)	24

Ky botim është pjesë e serisë “Raport i përditësuar i Agjendës së Reformave”, raporte kombëtare monitorimi që përcjellin zbatimin e Agjendave të Reformës si pjesë e Instrumentit për Reformë dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor, në kuadër të projektit për Monitorimin e Reformave.

Analiza i “Raporteve të përditësuara të Agjendës së Reformave” përqendrohet në progresin e zbatimit të detyrimeve specifike të vendit sipas IRRr-së. Monitorimi kryhet përmes një sërë treguesish proceduralë, të zbatimit të reformës dhe financiarë. Thelbi i ushtrimit të monitorimit është gjurmimi i progresit të reformave me afate të përcaktuara, duke vlerësuar statusin e zbatimit të tyre bazuar në provat që janë në dispozicion publikisht dhe dokumentacionin zyrtar të marrë nga autoritetet kombëtare, dhe, kur është e nevojshme, të plotësuar me informata nga institucione të pavarura dhe burime të shoqërisë civile. Vëmendje ndërsektoriale i kushtohet pjesëmarrjes dhe transparencës së akterëve.

Ushtrimi i monitorimit mbulon reforma të përzgjedhura të organizuara në të ashtuquajturat “fusha të politikave”, të krijuara duke koduar nënfushat e harmonizuara të politikave në Agjendat e Reformave. Fushat e zgjedhura të politikave, të cilat mundësojnë analiza në nivel rajonal, përcaktimin e standardeve dhe krahasueshmërinë, mbështeten nga burimet njerëzore në dispozicion dhe ekspertiza tematike e rrjetit TEN.

Për detaje metodologjike dhe procesin e përzgjedhjes së hapave të reformës, shih dokumentin e draftit të metodologjisë në këtë [link](#).

Raporti i përditësuar i Agjendës së Reformave është strukturuar si më poshtë. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore ofrojnë një përmbledhje të nivelit të lartë. Kapitujt mbi Marrëveshjet Ligjore dhe Institucionale dhe Kërkesat dhe Lëshimin e Fondeve monitorojnë progresin e përgjithshëm në aspektet procedurale dhe financiare të zbatimit të Agjendës së Reformave. Kapitulli i fundit, Reformat në Fokus: Domenet e politikave të Monitorimit të Reformave, ofron gjetje të pavarura të monitorimit mbi reformat e zgjedhura. Këtu, secili kapitull ofron një pasqyrë narrative të progresit dhe pengesave në zbatimin e Agjendës së Reformave për Kosovën.

Data e fundit për mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave për këtë raport të përditësuar është 31.12.2025. Zhvillimet e mëtejshme të politikave mund të ndryshojnë statusin e reformave që aktualisht janë në pritje dhe do të pasqyrohen në raportet vijuese.

Këto përditësime monitorimi nuk e zëvendësojnë rolin formal të vlerësimit që bart Komisioni Evropian.

Kosova e ka përfunduar semestrin e tretë të zbatimit të Instrumentit për Reformë dhe Rritje (IRRr) pa i ratifikuar zyrtarisht Marrëveshjet e Programit dhe të Kredive, që është një nga parakushtet e nevojshme për të përfituar nga pakoja financiare. Mungesa e vazhdueshme e stabilitetit politik e karakterizoi vitin 2025, gjatë të cilit vendi nuk kishte qeveri me mandat të plotë e as kuvend funksional. Paraliza politike i ka ngadalësuar ndjeshëm reformat ekzekutive, ndërsa i ka ndaluar plotësisht ato legjislative. Si pasojë, fondet e parafinancimit prej 7%, që arrinin vlerën prej 61.8 milionë euro nuk mund të shpërndareshin, ashtu si edhe fondet për disa nga hapat e reformës që tashmë janë zbatuar. Meqenëse tre semestra u përfunduan pa ndonjë ratifikim formal, kjo situatë e kërcënon seriozisht vitalitetin e IRRr-së për Kosovën. Prandaj, është me rëndësi të madhe të ndërmerren hapat e nevojshëm ligjorë dhe administrativë sapo të krijohet një qeveri dhe kuvend i ri.

Rekomandimet kryesore

- **Krijimi i organeve të nevojshme për zbatimin e IRRr-së**, siç është Komisioni i Monitorimit, emërimi i një koordinatori kombëtar dhe krijimi i një shërbimi auditimi për t'i përmbushur kërkesat teknike të marrëveshjeve dhe për t'i zbatuar reformat;
- **Prioritizimi i zbatimit** të hapave të reformës së qershorit 2025, pasi periudha e tyre e mospagimit përfundon në qershor 2026. Përtej këtij afati, Kosova do të humbiste në mënyrë të pakthyeshme qasjen në stimujt financiarë që lidhen me të;
- **Krijimi i një grupi pune për zbatim** që do t'i koordinojë aktivitetet brenda institucioneve të linjës për t'i zbatuar reformat më urgjente, veçanërisht 13 hapat e reformës të parashikuar për qershorin 2025, pasi afati shtesë i mos-pagesës përfundon në qershor 2026;
- **Përpilimi i një liste të ligjeve thelbësore** që duhet të miratohen me procedurë të përshpejtuar për t'i përmbushur disa nga hapat e reformës, pasi puna teknike për hartimin e tyre është kryer tashmë, si dhe të vazhdohet puna për hapat e tjerë që varen prej tyre.

Qeveria e Kosovës ishte një nga të parat në rajon që ka [negociuar dhe dorëzuar Agjendën e vet të Reformave \(AR\)](#), në gusht të vitit 2024. Që nga miratimi i Komisionit Evropian më 23 tetor të atij viti, në thelb nuk u ndërmor asnjë hap formal për t'i ratifikuar marrëveshjet dhe për ta zbatuar AR-në deri në fund të semestrit të tretë. Kuvendi që doli nga zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 nuk mund të konstituohej për arsye politike dhe për këtë arsye nuk mund të votonte për asnjë iniciativë ligjore. Ndërsa puna në nivel teknik brenda administratës publike ka vazhduar pa pushim, paraliza politike e ka penguar çdo tentativë për progres domethënës.

Marrëveshja e Programit u paraqit për votim më 4 dhjetor 2024, ndërsa Marrëveshja e Kredive u nënshkrua në nëntor të vitit 2025; për fat të keq, asnjëra nuk siguroi vota të mjaftueshme në Kuvend. Për fat të mirë, Kuvendi [ratifikoi të dy Marrëveshjet me procedura të përshpejtuara më 13 shkurt 2026](#). Tani qeveria e ardhshme duhet të emërojë një Koordinator Kombëtar dhe të krijojë një Shërbim Koordinues Kundër Mashtrimit. Përveç kësaj, krijimi i Komisionit për Monitorim të IRRr-së në Kosovë, siç parashikohet në Marrëveshjen e Programit, duhet të bëhet me pjesëmarrjen e shoqërisë civile. Tashmë është hartuar një Plan Komunikimi dhe Vizibiliteti dhe i është dorëzuar Komisionit Evropian për vlerësim.

Hapi Procedural	Statusi	Detajet e progresit
Dorëzimi i Agjendës së Reformës në BE	Është arritur	Agjenda përfundimtare e reformave u dorëzua më 9 tetor 2024
Vendimi për zbatimin e Agjendës së Reformave	Është arritur	Vendimi zbatues i KE-së u miratua më 24 tetor 2024
Ratifikimi dhe Hyrja në Fuqi e Marrëveshjes së Lehtësimit	Nuk është arritur	Marrëveshja nuk u ratifikua deri në fund të semestrit, më 31 dhjetor 2025.
Ratifikimi dhe Hyrja në Fuqi e Marrëveshjes së Kredive	Nuk është arritur	Marrëveshja nuk u ratifikua deri në fund të semestrit, më 31 dhjetor 2025.
Emërimi i Koordinatorit Kombëtar të AR-së	Nuk është arritur	Këta hapa nuk mund të realizoheshin sepse Marrëveshjet e Lehtësimit dhe të Kredive nuk u ratifikuan në kohën e duhur.
Shërbimi i Koordinimit Kundër Mashtrimit	Nuk është arritur	
Themelimi i Komisionit të Monitorimit të IRRr-së	Nuk është arritur	
Funksionalizimi i Komisionit të Monitorimit të IRRr-së	Nuk është arritur	
Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Komisionin e Monitorimit të IRRr-së	Nuk është arritur	
Infrastruktura Teknike për Monitorim dhe Raportim	Nuk është arritur	Plani i Komunikimit dhe Vizibilitetit u finalizua dhe iu dorëzua Komisionit Evropian.
Plani i komunikimit dhe vizibilitetit	Është arritur	

Meqenëse Kuvendi i Kosovës nuk i ratifikoi Marrëveshjet e Lehtësimit dhe të Kredive deri në fund të vitit 2025, kërkesa zyrtare për pagesë për semestrin e tretë nuk pati mundësi të dorëzohej. Megjithatë, periudha e mospagimit e aktivizuar në fund të vitit lejon që kërkesat për pagesë të paraqiten deri më 31 dhjetor 2026. Ndërkohë, Qeveria e Kosovës ka dorëzuar jozyrtarisht raportin e saj të zbatimit të Agjendës së Reformave, duke i respektuar afatet kohore të ndjekura nga vendet e tjera në rajon.¹ Si rezultat, Komisioni Evropian ka lëshuar një vlerësim joformal të këtij progresi.


Hapi Procedural	Statusi	Detajet e progresit
Kërkesë për parafinancim	Nuk është arritur	Këta hapa nuk mund të realizoheshin sepse Marrëveshjet e Lehtësimit dhe të Kredive nuk u ratifikuan në kohën e duhur.
Disbursimi i Para-Financimit	Nuk është arritur	
Dorëzimi i kërkesës për pagesë gjysmëvjetore	Nuk është arritur	
Dokumentacion mbështetës për përfundimin e reformës (raportimi kombëtar gjysmëvjetor)	Nuk është arritur	
Vlerësimi i KE-së mbi zbatimin e AR-së	Nuk është arritur	
Përmbushja e Kushteve të Përgjithshme	Nuk është arritur	
Parakushtet e përmbushura	Nuk është arritur	
Raporti Vjetor i Zbatimit të IRRr-së është përgatitur dhe dorëzuar	Nuk është arritur	

Agjenda e Reformave të Kosovës përcaktoi 20 hapa reformash për semestrin e tretë, që përfundon më 31 dhjetor 2025, me një total prej 134.6 milionë eurosh. Meqenëse Kuvendi i Kosovës nuk i kishte ratifikuar Marrëveshjet e Lehtësimit dhe të Kredive deri në fund të semestrit të tretë, kërkesa zyrtare për pagesë nuk mund të paraqitej dhe nuk u procesuan pagesa financiare gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, periudha e afatit të mospagesës e aktivizuar në fund të vitit lejon që kërkesat për pagesë të paraqiten deri më 31 dhjetor 2026.

Ndërkohë, Qeveria e Kosovës ka dorëzuar jozyrtarisht raportin e saj për zbatimin e Agjendës së Reformave, duke i respektuar afatet kohore të ndjekura nga vendet e tjera të rajonit. Si rezultat, Komisioni Evropian ka lëshuar një vlerësim jozyrtar të këtij progresi. Kjo pengesë legjislative u hoq zyrtarisht më 13 shkurt 2026, kur Kuvendi miratoi të dy Marrëveshjet përmes procedurave të përshpejtuara, duke mundësuar që procesi formal të ecë përpara.

¹ Intervistë me një nëpunës civil nga Zyra e Kryeministrit.

Përdorimi i fondeve i RGF, semstri i dytë 2025 (Korrik–Dhjetor 2025)



Në periudhën e ardhshme, qeveria dhe Kuvendi i Kosovës do të duhet ta përshpejtojnë ritmin e reformave për t'i përmbushur detyrimet, dhe për t'i respektuar afatet në mënyrë që të përfitojë nga stimujt financiarë të Instrumentit për Reforma dhe Rritje. Hapat e reformës së qershorit 2025 meritojnë vëmendje të veçantë, pasi periudha e tyre e mospagesës përfundon më 30 qershor 2026, duke krijuar një nevojë urgjente për t'i adresuar ato. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se cilësia e reformave është me rëndësi të madhe dhe nuk mund të sakrifkohet për hir të zbatimit të shpejtë. Kështu që, institucionet kosovare duhet të punojnë për t'i zbatuar reformat shpejt, në bashkëpunim të ngushtë me BE-në, partnerët ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile, për të siguruar zbatim të plotë.

Në këtë përditësim, Monitori i Reformave gjurmoi 5 hapa reformash në të gjitha fushat e politikave të përzgjedhura, nga 20 hapa reformash të planifikuar për zbatim deri në datën e fundit. Kjo përfshin hapat e reformës me afate në semestrin raportues, dhjetor 2025, si dhe hapat e papërfunduar nga semestrat e mëparshëm (p.sh. dhjetor 2024 dhe qershor 2025) që mbeten të rëndësishëm për zbatimin dhe vlerësimin e IRRr-së. Ky përditësim mbulon gjithsej 17 hapa reformash.

Tabela më poshtë ofron një pasqyrë përmbledhëse sipas fushës së politikave dhe domeneve të politikave, duke treguar se cilat reforma monitorohen. Ajo tregon se sa hapa reformash monitorohen në secilin rast si një pikë hyrjeje për analizën e detajuar të domenit të politikave dhe vlerësimet e hapave të reformave të paraqitura në pjesët vijuese.

Fusha e politikave (e harmonizuar)		
Domeni i politikave	Reformat / Hapat e reformës	Në fokus [mbetet për t'u kryer dhe është monitoruar]
Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore		
Reformat gjyqësore	Përmirësimi i performancës, integritetit, llogaridhënies dhe efikasitetit të gjyqësorit, duke përfshirë zbatimin e Deklaratës së Përbashkët të Zotimit.	1/5 hapa, mbetet për t'u kryer dhe është monitoruar
Lufta kundër korrupsionit	Përmirësimi i efikasitetit për ta luftuar korrupsionin përmes parandalimit dhe ndëshkimit dhe duke përmirësuar kornizën strategjike.	0/5 hapa, mbetet për t'u kryer dhe është monitoruar
Lufta kundër krimit të organizuar	Zbatimi në mënyrë efektive i strukturave organizative të policisë duke mundësuar një qasje të udhëhequr nga intelijenca për të luftuar krimin e organizuar, të zbatohet një qasje strategjike për të luftuar krimin e organizuar dhe të përmirësohet bashkëpunimi shumë-diplinor në raste komplekse, duke çuar në rritjen e dënimeve.	1/3 hapa, mbetet për t'u kryer dhe është monitoruar
Tranzicioni Digjital		
Shërbimet publike digjitale	Të sigurohet ofrimi i shërbimeve publike digjitale të përshtatshme për përdoruesit përmes zvogëlimit të barrës administrative dhe përmirësimit të cilësisë dhe rritjes së numrit të shërbimeve online.	1/7 hapa, mbetet për t'u kryer dhe është monitoruar
Qëndrueshmëria kibernetike	Korniza gjithëpërfshirëse për qëndrueshmërinë kibernetike (duke futur kërkesat e Direktivës NIS2 dhe duke forcuar institucionet përkatëse).	0/4 hapa, mbetet për t'u kryer dhe është monitoruar
Energjia dhe Tranzicioni i Gjelbër		
Burimet e ripërtëritshme	Zhvillimi i procedurave transparente dhe konkurruese për shtrirjen e energjisë së ripërtëritshme.	1/3 hapa, mbetet për t'u kryer dhe është monitoruar
Reformat e tregut	Zbatimi i Direktivës për Eficiencën e Energjisë dhe Direktivës për Performancën Energjetike në Ndërtesa.	0/3 hapa, mbetet për t'u kryer dhe është monitoruar
Kapitali Njerëzor		
Arsimi dhe aftësimi profesional (AAP)	Të harmonizohet arsimi me nevojat e tregut të punës nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin e biznesit dhe nëpërmjet rishikimit të kornizës ligjore për AAP-në dhe arsimin për të rritur, si dhe zhvillimi i të nxënit përmes praktikës në shkollat e AAP-së.	1/6 hapa, mbetet për t'u kryer dhe është monitoruar
Mjedisi i Biznesit dhe Zhvillimi i Sektorit Privat (A)		
Politika e konkurrencës/ Ndihma shtetërore	Lehtësimi i investimeve të sektorit privat dhe përmirësimi i mekanizmave për tërheqjen e investimeve të huaja direkte në sektorët strategjikë, duke nxitur miratimin e produkteve dhe shërbimeve me vlerë të shtuar dhe inovacion.	3/6 hapa, mbetet për t'u kryer dhe është monitoruar
Ndërmarrjet shtetërore (NSH)	Përmirësimi i qeverisjes, efikasitetit dhe llogaridhënies së Ndërmarrjeve Publike (NP) për të rritur kontributin e tyre në ekonomi.	1/3 hapa, mbetet për t'u kryer dhe është monitoruar

Fokusi kryesor i reformave të politikave në *Reformat Gjyqësore* në semestrin e tretë ishte miratimi i Kodit Civil, funksionalizimi i Njesisë për Përkthim në Zyrën e Kryeministrit, futja e masave të reja në rregulloren e procedurës së Kuvendit dhe ndërprerja e regjimit pa viza me të paktën një vend që kërkon viza për BE-në. Në semestrat e mëparshëm, reformat përfshinin shfrytëzimin e plotë të CMIS nga sistemi gjyqësor dhe zbatimin e kontrolleve të integritetit për gjyqtarët dhe prokurorët. Qëllimi i përgjithshëm i këtyre reformave është përsheptimi i miratimit të *acquis* nga Kosova duke krijuar një sistem gjyqësor që funksionon mirë dhe duke përmirësuar legjislacionin. Për shkak të bllokimit politik që karakterizoi vitin 2025, u bë pak përparim, veçanërisht në reformat që kërkojnë miratim legjislativ, siç është Kodi Civil.

Reformat Hapat e reformës	Afati i fundit (i paraparë)	Statusi i zbatimit	Gjetjet e Monitorit të Reformave
Përmirësimi i performancës, integritetit, llogaridhënies dhe efikasitetit të gjyqësorit, duke përfshirë zbatimin e Deklaratës së Përbashkët të Zotimit			
Përforcimi i mekanizmit të monitorimit dhe raportimit për të siguruar përdorimin e plotë dhe efektiv të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Rasteve (SIMR), bazuar në llogaridhënie dhe lidhur me masat disiplinore.	Dhjetor 2024	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në dhjetor 2026	Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka miratuar një rregullore për ta bërë të detyrueshëm përdorimin e SIMR-it. Grupi punues kryen raportime të rregullta mbi përdorimin e platformës. KGJK ka marrë masa disiplinore kundër një zyrtari për mospërdorimin e saj.
Kryerja e kontrolleve efektive të integritetit në përputhje me standardet evropiane përmes verifikimit të rregullt dhe të plotë të deklarimit të pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, duke përfshirë edhe verifikimin e informacionit me institucionet përkatëse; të ndryshohet Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve për t'i adresuar gjetjet e misionit të TAIEK për rishikim nga kolegët, duke përfshirë edhe themelimin e një organi të specializuar hetimor; të përmirësohet sistemi i rekrutimit duke forcuar mekanizmat aktualë për verifikimin e të dhënave të kandidatëve, duke përfshirë sqarimin e fushëveprimit dhe procedurave të tij. Të sigurohet që reformat legjislative që zbatojnë Deklaratën e Përbashkët të Zotimit të jenë në përputhje me Standardet Evropiane; dhe të lejohet kohë e mjaftueshme për konsultimin dhe shqyrtimin e tyre për këtë qëllim.	Qershor 2025	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në qershor 2026	Ligji i ri për masat disiplinore nuk u miratua, megjithëse kaloi nëpër një proces transparent konsultimi. Teksti i projektligjit përfshinë një organ të posaçëm hetimor. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka krijuar një politikë verifikimi të plotë të deklarimit vjetor të pasurisë nga çdo gjyqtar dhe prokuror çdo tre vjet, që do të thotë se ka siguruar verifikimin e të paktën një të tretës së të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve çdo vit.
Miratimi i Kodit Civil	Dhjetor 2025	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në dhjetor 2026	Kodi Civil u prezantua në Kuvend, por nuk arriti të marrë shumicën e nevojshme të votave. Prandaj, drafti duhet t'i riparaqitet kuvendit të sapokrijuar.

PËRMIRËSIMI I PERFORMANCËS, INTEGRITETIT, LLOGARIDHËNIES DHE EFIKASITETIT TË GJYQËSORIT, DUKE PËRFSHIRË ZBATIMIN E DEKLARATËS SË PËRBASHKËT TË ZOTIMIT

- ***Përforcimi i mekanizmit të monitorimit dhe raportimit për të siguruar përdorimin e plotë dhe efektiv të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Rasteve (SIMR), bazuar në llogaridhënie dhe lidhur me masat disiplinore- dhjetor 2024 - Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Ky hap reformues synon të përmirësojë llogaridhënien e sistemit gjyqësor duke përmirësuar përdorimin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Rasteve (SIMR). SIMR është një platformë digjitale e centralizuar që siguron transparencë të plotë duke mundësuar menaxhimin dhe ndjekjen virtuale të lëndëve. Për të zbatuar këtë hap reformues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial kurdo që duhet, duhet të miratojë rregullore për ta bërë përdorimin e SIMR-it të detyrueshëm dhe të marrë masa disiplinore për mospërdorimin e sistemit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka ndërmarrë masa për ta përmbushur këtë hap të reformës duke miratuar një rregullore të brendshme që e bën të detyrueshëm përdorimin e SIMR-it. KGJK-ja ka publikuar [Rregulloren zyrtare](#) mbi Përdorimin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Rasteve (SIMR). Sipas përgjigjes për Lirinë e Informacionit, KGJK-ja ka raportuar se po monitoron përdorimin e SIMR-it nga gjyqtarët dhe ka ndërmarrë masa disiplinore për mospërdorimin e tij. Këto masa deri më tani përfshijnë vërejtje me shkrim. Në [Raportin e Këshillit të Evropës](#) thuhet se, që nga viti 2024, SIMR është në përdorim në të gjitha gjykatat në Kosovë. Megjithatë, ka pasur raportime në media se [Prokuroria Speciale nuk e ka shfrytëzuar](#) sistemin. Nuk ka pasur asnjë përditësim mbi zbatimin e këtij hapi reformues, i cili pret vlerësimin e Komisionit Evropian.

- ***Kryerja e kontrolleve efektive të integritetit në përputhje me standardet evropiane përmes verifikimit të rregullt dhe të plotë të deklarimit të pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, duke përfshirë edhe verifikimin e informacionit me institucionet përkatëse; të ndryshohet Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve për t'i adresuar gjetjet e misionit të TAIEX për rishikim nga kolegët, duke përfshirë edhe themelimin e një organi të specializuar hetimor; të përmirësohet sistemi i rekrutimit duke forcuar mekanizmat aktualë për verifikimin e të dhënave të kandidatëve, duke përfshirë sqarimin e fushëveprimit dhe procedurave të tij. Të sigurohet që reformat legjislative që zbatojnë Deklaratën e Përbashkët të Zotimit të jenë në përputhje me Standardet Evropiane; dhe të lejohet kohë e mjaftueshme për konsultimin dhe shqyrtimin e tyre për këtë qëllim. - Qershor 2025 - Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Për një kohë të gjatë, ka pasur diskutime rreth reformimit të sistemit gjyqësor dhe madje edhe krijimit të një [procedure vetingu](#). Ndërkohë që ky hap reformues nuk është aq gjithëpërfshirës sa ideja fillestare, ai prezanton disa procedura verifikimi duke verifikuar pasuritë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke kryer verifikime të së kaluarës për emërimet e reja dhe duke ndryshuar ligjin ekzistues për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ekziston një [Projektligj, që amendon Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve](#), i cili nuk është miratuar për shkak të jostabilitetit politik në vitin 2025. Teksti i projektligjit përfshin një organ të specializuar hetimor, sipas të cilit sa herë që kryhet një kundërvajtje e rëndë nga një gjyqtar ose prokuror, do të formohet një komision i posaçëm hetimor për ta hetuar rastin. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka vendosur një politikë të kontrollit të pasurive të anëtarëve të sistemit gjyqësor, pra gjyqtarëve dhe prokurorëve, çdo tri vjet, e cila vazhdon të funksionojë pa probleme. Kuvendi i ardhshëm duhet ta miratojë ligjin për ta përfunduar këtë hap reforme.

- ***Miratimi i Kodit Civil - Dhjetor 2025– Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Kjo masë synon ta modernizojë kornizën e së drejtës civile të Kosovës duke miratuar [Kodin Civil](#) të lartpërmendur, dhe përputhet me [Kornizat dhe standardet ligjore evropiane](#). Miratimi i Kodit Civil synon të forcojë stabilitetin dhe unitetin e kornizës ligjore, si dhe ta optimizojë strukturën e mjedisit ligjor.

Pika kryesore referuese ose momenti kyç për këtë reformë kërkonte miratim parlamentar dhe hyrje në fuqi ligjore deri në dhjetor 2025. Që nga afati i fundit, Kodi Civil i ishte paraqitur Kuvendit [pa arritur të sigurojë votat e nevojshme për miratim](#). Prandaj, ligji nuk u miratua dhe nuk hyri në fuqi brenda afatit të raportuar. Palët e treta dhe akterët e jashtëm që përbëjnë shoqërinë civile [lëshuan disa deklarata](#) lidhur me këto zhvillime.

Pavarësisht procedurës së votimit, procedura e hartimit iu nënshtrua një game të gjerë konsultimesh, pasi, krahas procedurës së zakonshme të [procesit të konsultimit](#), grupi punues i Ministrisë së Drejtësisë organizoi mbi tridhjetë takime dhe aktivitete për ta prezantuar draftin dhe për të mbledhur ide. Megjithatë, organizatat e shoqërisë civile kanë pasur kritikën e tyre, veçanërisht në lidhje me [mungesën e rregullores](#) për të drejtat për martesë të çiftëve të të njëjtit seks. Megjithatë, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë [e ka mbështetur këtë draft dhe ka paralajmëruar](#) se dështimi për ta miratuar Kodin Civil do të kishte pasoja të konsiderueshme për Kosovën edhe në lidhje me Agjendën e Reformave. Me krijimin e legjislaturës së re, ky hap reformues përfaqëson një rezultat relativisht lehtë të arritshëm për zbatimin e Agjendës së Reformave dhe për këtë arsye duhet të vazhdojë në kohën e duhur.

Reformat në *Luftën Kundër Korrupsionit dhe Luftën Kundër Krimin të Organizuar* u përqendruan kryesisht në përmirësimin e gatishmërisë institucionale të Kosovës për t'u përballur me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Këto çështje jo vetëm që dëmtojnë sundimin e ligjit dhe ekonominë, por edhe pengojnë përpjekjet e vendit për anëtarësim në BE. Hapat e reformës në këtë domen politikash përfshijnë miratimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit, rritjen e numrit të zyrtarëve që sinjalizojnë krimet, një rritje të numrit të rasteve që Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ia përcjell prokurorisë, uljen e kohës së pritjes për rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar në maksimum një vit, dhe një rritje të numrit të padive dhe hetimeve për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Nuk ka hapa reformash të dedikuar për semestrin e tretë në këtë nën-domen. Megjithatë, është raportuar pak progres që nga semestri i kaluar për shkak të mandatit të përkohshëm të qeverisë për pjesën më të madhe të vitit 2025. Në anën tjetër, është arritur progres i mirë në hapin e reformës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në drejtim të rritjes së raportimit nga sinjalizuesit, gjë që mund t'i atribuohet faktit se, si një organizatë e pavarur, ajo është shumë më pak e prekur nga puna e qeverisë dhe Kuvendit.

Reformat Hapat e reformës	Afati i fundit (i paraparë)	Statusi i zbatimit	Gjetjet e Monitorit të Reformave
Përmirësimi i efikasitetit për ta luftuar korrupsionin përmes parandalimit dhe ndëshkimit dhe duke përmirësuar kornizën strategjike.			
Miratimi i një Strategjie kundër Korrupsionit për vitet 2024–2027, në përputhje me standardet evropiane dhe parimet kushtetuese kombëtare. Përfshirja e planeve vjetore të veprimit me objektiva të matshme dhe një mekanizëm raportimi mbi zbatimin e tyre.	Dhjetor 2024	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në dhjetor 2026	Strategjia nuk u miratua nga qeveria. Procesi i konsultimit ishte publik dhe drafti u publikua. Nuk u zhvillua asnjë aktivitet informues për ta prezantuar strategjinë.
Rritja e numrit të raportimeve të sinjalizimit të përpunuara nga Agjencia (për 30% krahasuar me vitin 2024).	Dhjetor 2024	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në dhjetor 2026	Pati një rritje prej 140% të rasteve të raportuara në AKK dhe një rritje prej 50% të rasteve të dërguara në prokurori.
Zbatimi në mënyrë efektive i strukturave organizative të policisë duke mundësuar një qasje të udhëhequr nga inteligjenca për të luftuar krimin e organizuar, të zbatohet një qasje strategjike për të luftuar krimin e organizuar dhe të përmirësohet bashkëpunimi shumëdisiplinor në raste komplekse, duke çuar në rritjen e dënimeve.			
Miratohet strategjia për luftimin e krimin të organizuar, duke u përqendruar në forcimin e bashkëpunimit institucional, hetimeve financiare dhe kapaciteteve të inteligjencës; krijohet fondi i konfiskimit; krijohet struktura e inteligjencës në nivel rajonal dhe qendror të policisë me burime të mjaftueshme njerëzore dhe teknike.	Qershor 2025	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në dhjetor 2026	Strategjia nuk u miratua nga qeveria pasi grupi i punës u krijua tek në tetor 2024. Këtu përfshihet një mekanizëm koordinimi ndërinstitutional. Nuk është krijuar ndonjë fond konfiskimi dhe, rrjedhimisht, as nuk është vënë në funksion, pasi puna është duke vazhduar. Drafti do të jetë i hapur për konsultim sapo të përfundojë.

PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT PËR TA LUFTUAR KORRUPSIONIN PËRMES PARANDALIMIT DHE NDËSHKIMIT DHE DUKE PËRMIRËSUAR KORNIZËN STRATEGJIKE

- ***Miratimi i një Strategjie kundër Korrupsionit për vitet 2024–2027, në përputhje me standardet evropiane dhe parimet kushtetuese kombëtare. Përfshirja e planeve vjetore të veprimit me objektiva të matshme dhe një mekanizëm raportimi mbi zbatimin e tyre.– Dhjetor 2024 - Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Qeveria e Kosovës ka filluar procedurat e miratimit të një strategjie kundër korrupsionit për periudhën 2024-2027. Për këtë qëllim, një draft iu prezantua publikut dhe është vënë në [konsultim publik](#), megjithëse ishte në dispozicion vetëm për 13 ditë, në kundërshtim me vetë [rregulloren](#) e qeverisë që kërkon të paktën 15 ditë pune konsultimesh, dhe vetëm dy organizata të shoqërisë civile patën mundësi t'i dorëzojnë komentet e tyre. Që atëherë, nuk është shënuar fare progres sepse, sipas [Ligjit për Qeverinë](#), një qeveri teknike nuk mund të miratojë strategji të reja. Qeveria e ardhshme duhet ta miratojë një strategji të re sa më shpejt të jetë e mundur. Përveç kësaj, qeveria duhet t'i adresojë [kritikat e shumta](#) të ngritura nga organizatat e shoqërisë civile dhe Bashkimi Evropian.

Disa nga kritikat përfshijnë mungesën e një plani veprimi të zhvilluar mirë me veprime lehtë të identifikueshme. Gjithashtu, dokumenti përmend një mekanizëm monitorimi; megjithatë, nuk sqaron se si funksionon ai dhe përgjegjësitë e tij nuk janë të përcaktuara qartë. Disa organizata të shoqërisë civile [kanë kritikuar](#) çekuilibrin ekzistues ku Gjykata Kushtetuese vendoset në një rol mbikëqyrës mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillin Prokurorial (KPK). [Grupi për Studime Juridike dhe Politike \(GLPS\)](#) nga ana tjetër, ka vënë në dukje mungesën e infrastrukturës digjitale për t'i kryer reformat e synuara, adresimin jo të duhur të korrupsionit në administratën publike dhe se ndryshimet ligjore të prokurimit publik nuk janë sqaruar. Drafti nuk ka arritur t'i adresojë shumë nga komentet thelbësore të ngritura nga BE-ja. Përveç kësaj, nuk ka masa të mjaftueshme për t'i adresuar konfliktet e interesit, korrupsionin në sektorin privat dhe çështjet që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar.

- ***Rritja e numrit të raportimeve të sinjalizimit të përpunuara nga Agjencia (për 30% krahasuar me vitin 2024).– Dhjetor 2024 - Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Ky hap reformues synon ta përmirësojë llogaridhënien e zyrtarëve publikë duke i nxitur sinjalizuesit e mundshëm që të raportojnë raste. Në përgjigje ndaj një kërkesë për informata, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka raportuar se ka arritur rritjen e synuar deri në fund të vitit 2024. Në vitin 2024,

APK përpunoi gjithsej 48 raporte, që përfaqësojnë një rritje prej 140%. Për të rritur shtrirjen dhe ndikimin e saj, APK ka zhvilluar një platformë online, një aplikacion celular dhe ka trajnuar zyrtarë në të gjitha institucionet për të mbledhur dhe monitoruar provat. Përveç kësaj, APK ka organizuar të paktën 10 seanca trajnimi me zyrtarë publikë për t'i informuar ata rreth të drejtave të tyre. Që atëherë nuk ka pasur zhvillime dhe ky hap reformues pret vlerësimin zyrtar të Komisionit Evropian.

PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT PËR TA LUFTUAR KORRUPSIONIN PËRMES PARANDALIMIT DHE NDËSHKIMIT DHE DUKE PËRMIRËSUAR KORNIZËN STRATEGJIKE

- ***Miratohet strategjia për luftimin e krimit të organizuar, duke u përqendruar në forcimin e bashkëpunimit institucional, hetimeve financiare dhe kapaciteteve të inteligjencës; krijohet fondi i konfiskimit; krijohet struktura e inteligjencës në nivel rajonal dhe qendror të policisë me burime të mjaftueshme njerëzore dhe teknike.- qershor 2025 - Vlerësimi i KE-së është në pritje:***

Kosova ka miratuar **strategjinë e vet të fundit kundër krimit të organizuar** në vitin 2018, dhe afati i saj kohor përfundoi në vitin 2022. Që atëherë, qeveria ka punuar për të hartuar dhe miratuar një strategji të re. Ministria e Punëve të Brendshme i është përgjigjur një kërkesë për Lirinë e Informimit dhe ka sqaruar se grupi i punës për hartimin e strategjisë është krijuar. Megjithatë, deri më sot, asnjë draft nuk i është paraqitur publikut dhe as nuk i është nënshtruar konsultimeve. Strategjia është bërë një tjetër viktimë e paralizës së zgjatur politike të vitit 2025., dhe qeveria e ardhshme duhet të punojë për hartimin e një dokumenti të mirë, me kontributin e shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë si BE-ja, dhe ta miratojë atë në qeveri sa më shpejt të jetë e mundur.

Disa sugjerime për qeverinë e re janë që ligji i ri duhet të krijojë një fond për konfiskimin e aseteve, ta funksionalizojë atë përmes një llogarie aktive dhe të përcaktojë rregullat e procedurës. Përveç kësaj, do të ketë një mekanizëm koordinimi ndërinstitutional për të siguruar funksionimin e rrjedhshëm të sistemit në bashkëpunim me të gjitha institucionet publike përkatëse. Edhe pse Ministria e Punëve të Brendshme aktualisht ka parashikuar krijimin e një mekanizmi të tillë, ajo duhet të sqarojë se si do të funksionojë ai.

Reformat në *Tranzicionin Digjital* synojnë modernizimin e shërbimeve të ofruara për qytetarët duke i digjitalizuar kurdo që është e mundur. Në semestrin e tretë, reforma e politikave në këtë domen përfshinte përafrimin me Aktin e Infrastrukturës Gigabit të Bashkimit Evropian, i cili synon të vendosë internet 5G me shpejtësi të lartë në tërë BE-në. Në të kaluarën, një hap tjetër reformues synonte të zvogëlonte barrën administrative mbi qytetarët duke rishikuar të gjitha ligjet duke përdorur metodologjinë e re të zvogëlimit të barrës administrative. Disa nga hapat e tjerë të reformës përfshijnë: eliminimin e arkave fiskale, forcimin e ndërlidhjes së regjistrit civil me regjistra të tjerë qeveritarë, siç është Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), Administrata Tatimore e Kosovës, Sistemi i Adresave (ARIS), ngritjen e 10 regjistrave publikë të standardizuar dhe digjitalizuar nga administrata për ta përmirësuar parimin «vetëm një herë», ofrimin e 50% të shërbimeve publike për qytetarët dhe bizneset online dhe përputhshmëri të plotë me Rregulloren e BE-së për Identitetin Digjital, arritjen e gatishmërisë për të marrë pjesë në Portofolin e Identitetit Ballkanik. Harmonizimi përfundimtar me standardet e BE-së për ofrimin e shërbimeve digjitale do ta zvogëlojë burokracinë dhe do të mundësojë shfrytëzimin e plotë të potencialit ekonomik të vendit, duke përshpejtuar gjithashtu integrimin në BE.

Reformat Hapat e reformës	Afati i fundit (i paraparë)	Statusi i zbatimit	Gjetjet e Monitorit të Reformave
Të sigurohet ofrimi i shërbimeve publike digjitale të përshtatshme për përdoruesit përmes zvogëlimit të barrës administrative dhe përmirësimit të cilësisë dhe rritjes së numrit të shërbimeve online.			
100% e ligjeve të reja që vendosin një barrë administrative rishikohen në kontekstin e parandalimit të barrës administrative sipas metodologjisë së Zvogëlimit të Barrës Administrative (ZBA).	Qershor 2025	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në qershor 2025	50 nga 52 ligjet e iniciuara brenda kësaj periudhe kohore u shqyrtuan përmes këndvështrimit të ZBA-së.

TË SIGUROHET OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE DIGJITALE TË PËRSHTATSHME PËR PËRDORUESIT PËRMES ZVOGËLIMIT TË BARRËS ADMINISTRATIVE DHE PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË DHE RITJES SË NUMRIT TË SHËRBIMEVE ONLINE

- **100% e ligjeve të reja që vendosin një barrë administrative rishikohen në kontekstin e parandalimit të barrës administrative sipas metodologjisë së Zvogëlimit të Barrës Administrative - Qershor 2025 - Vlerësimi i KE-së në pritje:**

Në vitet e fundit, një [Program i ri i Zvogëlimit të Barrës Administrative](#) është prezantuar për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët. Në këtë drejtim, në vitin 2024, qeveria miratoi 52 ligje të reja, nga të cilat 50 u rishikuan sipas metodologjisë së re për të ulur barrën administrative. Pasi që kjo do të përkthejë në një shkallë suksesi mbi 90%, tregon progres të mirë në zbatimin e këtij hapi të reformës. Megjithatë, vendimi përfundimtar mbi statusin e zbatimit do të merret nga Komisioni Evropian.

Deri më tani, nuk janë përcaktuar hapa reformash për tre semestrat e parë në fushën e politikave të *Sigurisë Kibernetike*. Megjithatë, në semestrat e ardhshëm, disa hapa reformash do të përfshijnë funksionalizimin e një Ekipi për Reagim ndaj Emergjencave Kompjuterike (CERT), miratimin e një ligji të ri për sigurinë kibernetike, zbatimin e Direktivës 2 për Sigurinë e Rrjetit dhe Informacionit (NIS2) dhe krijimin e Agjencisë për Siguri Kibernetike (ASK). Këto reforma do t'i adresojnë dobësitë aktuale në sektorin e sigurisë kibernetike duke krijuar agjenci të reja dhe duke miratuar standardet e BE-së. Ky proces do të ndihmojë gjithashtu në miratimin e legjislacionit përkatës që do t'i bëjë negociatat për anëtarësim më të lehta në të ardhmen.

Prodhimi i energjisë në Kosovë mbetet **shumë i varur nga termocentralet me qymyr**, të cilat gjenerojnë ndotje të konsiderueshme dhe janë shumë joefikase. Jo vetëm që kjo situatë shkakton probleme mjedisore, por modeli i bazuar në qymyr do të paraqesë gjithashtu pengesa të mëdha ekonomike kur Kosova t'i bashkohet BE-së dhe më pas do të krijojë kosto shtesë për prodhuesit brenda **Sistemit të Tregtimit të Emetimeve (ETS)**, i cili i taton kompanitë që mbështeten në lëndët djegëse fosile për prodhim. Prandaj, Tranzicioni i Gjellbër zë një vend qendror në Agjendën e Reformave. Në semestrin e tretë, hapat e reformës përfshijnë miratimin e një ligji për rregullatorin e energjisë, rishikimin e akteve ligjore dytësore që lidhen me ligjin për ndryshimet klimatike dhe thjeshtimin e procedurave të lejeve për projektet e energjisë së ripërtëritshme. Semestrët e kaluar përfshinë një njoftim për një ankand për të vendosur në përdorim parkun me energji ere prej 150 MW. Ndërsa është vërejtur njëfarë progresi në këto politika, mandati i përkohshëm i qeverisë për pjesën më të madhe të vitit 2025, i kombinuar me moskonstituimin e Kuvendit, pengoi arritjen e progresit domethënës.

Reformat Hapat e reformës	Afati i fundit (i paraparë)	Statusi i zbatimit	Gjetjet e Monitorit të Reformave
Zhvillimi i procedurave transparente dhe konkurruese për shtrirjen e energjisë së ripërtëritshme.			
Thjeshtimi i procedurave për dhënien e lejeve për projektet e energjisë së ripërtëritshme	Dhjetor 2025	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në dhjetor 2026	Ligji për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme, i cili është në fuqi nga viti 2024, rregullon bazën ligjore. Aktet nënligjore janë hartuar dhe janë ende në pritje të miratimit. Korniza e lejeve nuk është zbatuar ende.
Shpallja e një plani tre-vjeçar të ankandit dhe nisja e një ankandi për të vendosur në përdorim 150 MW energji të erës.	Dhjetor 2024	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në dhjetor 2026	Ankandi ka filluar; megjithatë, nuk është për 150 MW.

ZHVILLIMI I PROCEDURAVE TRANSPARENTE DHE KONKURRUESE PËR SHTRIRJEN E ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME

- ***Thjeshtimi i procedurave për dhënien e lejeve për projektet e energjisë së ripërtëritshme – Dhjetor 2025 - Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Kjo reformë synon të lehtësojë qasjen për familjet dhe instalimet e mëdha, siç janë fermat diellore, për të marrë licencë për platformat e prodhimit të energjisë së ripërtëritshme. Për këtë qëllim, Kuvendi ka miratuar **Ligjin për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme**, në vitin 2024, për të ofruar kornizën legjislative dhe një sërë rregulloresh për t'i thjeshtuar procedurat administrative për shtrirjen e metodave të energjisë së ripërtëritshme në përputhje me Direktivën e BE-së për Energjinë e Ripërtëritshme (RED II).

Ministria e Ekonomisë ka sqaruar në një kërkesë për Lirinë e Informimit se Termat e Referencës (ToR) për Sistemin e Lejeve Elektronike janë përcaktuar në shkurt 2024. Megjithatë, zbatimi i sistemit të lejeve të digjitalizuara varet nga burimet financiare ose buxhetimi dhe procedurat e prokurimit.

Edhe pse legjislacioni parësor është në fuqi, Ministria e Ekonomisë duhet të miratojë legjislacionin dytësor për t'i thjeshtuar procedurat e lejeve sa më shpejt që është e mundur. Ajo tashmë ka [miratuar një akt administrativ](#) në lidhje me procesin e tenderimit për mbështetje për energjisë të ripërtëritshme, dhe vetëm pas adresimit të kësaj çështjeje mund të arrihen plotësisht reformat e shtrirjes së energjisë së ripërtëritshme. Me qeverinë e re që merr detyrën, një nga prioritetet në fushën e energjisë duhet të jetë miratimi i akteve nënligjore për ta përmbyshur këtë hap reformues.

- ***Shpallja e një plani tre-vjeçar të ankandit dhe nisja e një ankandi për të vendosur në përdorim 150 MW energji të erës - dhjetor 2024 - Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Kosova mbështetet shumë te qymyri për prodhimin e energjisë dhe, në vitet e fundit, qeveria ka ndërmarrë hapa fillestarë për ta hequr gradualisht qymyrin nga përdorimi. Për të zënë hapin me pjesën tjetër të Bashkimit Evropian, që po kalon drejt prodhimit të energjisë së ripërtëritshme, qeveria e Kosovës ka miratuar një [Strategji të re të Energjisë](#) për periudhën 2022-2031. Kjo strategji do të mundësojë nxjerrjen përfundimtare nga përdorimi të termocentraleve të vjetëruara me qymyr dhe futjen e deri në 1600 MW të prodhimit të energjisë së ripërtëritshme.

Në këtë kontekst, Ministria e Ekonomisë (ME) duhej të niste një plan të ri tre-vjeçar ankandi. Ky plan ishte hartuar për të shmangur disa nga vendimet e mëparshme ad hoc të marra për të shtrirë burimet e ripërtëritshme dhe për të ofruar qartësi afatgjatë. Brenda këtij plani, qeveria duhet të shpallë një ankand për një park me energji ere prej 150 MW. Ankandi duhet të jetë transparent dhe konkurrues, me komunikim të konsiderueshëm publik.

Ministria e Mjedisit ka nisur [një ankand të ri](#) për një park me energji ere, megjithatë, me një kapacitet prodhimi prej 100 MW. Kjo vjen pas [planit të ankandit të shpallur më parë](#), një dokument trevjeçar që u ofron investitorëve qartësi mbi planet afatgjata të qeverisë. Shpallja është në dispozicion në [një faqe interneti](#) dhe u reklamua gjerësisht në mediat sociale. Edhe pse plani dhe ankandi përmbyshin shumë nga kërkesat për një reformë të zbatuar mirë, ankandi është shpallur për një projekt prej 100 MW, jo projektin prej 150 MW të parashikuar fillimisht, gjë që paraqet mangësi të konsiderueshme. Komisioni Evropian nuk e ka dhënë ende vlerësimin e tij.

Kosova ka pasur probleme sistematike në sektorin e arsimit, siç dëshmohet nga [Rezultatet e PISA-s](#) që e vendosin vendin afër fundit të listës. Prandaj, Kapitali Njerëzor ka numrin më të madh të reformave të politikave në Agjendën e Reformës për t'i adresuar këto çështje sistematike. Disa nga hapat e reformës të parashikuara për semestrin e tretë janë hyrja në fuqi e një ligji të ri që rregullon arsimin dhe aftësimin profesional, një rritje në grupmoshën 0-2 vjeç që ndjekin kujdesin ditor në 8% dhe zbatimin e planit të riorganizimit në të paktën 40% të shkollave. Më parë, një nga hapat më të rëndësishëm të reformës përfshinte arritjen e anëtarësimit të plotë në ENQA, gjë që u arrit në korrik 2025. Në përgjithësi, ritmi i reformave në këtë domen politikash është i ngadalshëm dhe qeveria e ardhshme duhet t'i miratojë shpejt ligjet përkatëse dhe t'i zbatojë reformat ekzekutive.

Reformat Hapat e reformës	Afati i fundit (i paraparë)	Statusi i zbatimit	Gjetjet e Monitorit të Reformave
Të harmonizohet arsimi me nevojat e tregut të punës nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin e biznesit dhe nëpërmjet rishikimit të kornizës ligjore për AAP-në dhe arsimin për të rritur, si dhe zhvillimi i të nxënësve përmes praktikës në shkollat e AAP-së.			
Anëtarësim i plotë në ENQA	Qershor 2025	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në qershor 2026	Anëtarësimi i plotë është arritur.
Hyrja në fuqi e ligjit të ri që rregullon AAP-në (duke përfshirë qeverisjen, kurrikulat, formulën e financimit dhe rrjetin e institucioneve të AAP-së) dhe arsimin e të rriturve (AE) në përputhje me standardet evropiane.	Dhjetor 2025	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në dhjetor 2026	Një projektligj për Arsimin dhe Aftësimin Profesional është paraqitur për konsultime, në pritje të miratimit nga Kuvendi.

TË HARMONIZOHET ARSIMI ME NEVOJAT E TREGUT TË PUNËS NËPËRMJET BASHKËPUNIMIT TË NGUSHTË ME KOMUNITETIN E BIZNESIT DHE NËPËRMJET RISHIKIMIT TË KORNIZËS LIGJORE PËR AAP-NË DHE ARSIMIN PËR TË RRIUR, SI DHE ZHVILLIMI I TË NXËNËT PËRMES PRAKTIKËS NË SHKOLLAT E AAP-SË

• **Anëtarësim i plotë në ENQA– Qershor 2025 - Vlerësimi i KE-së në pritje:**

Edhe pse Kosova më parë ishte anëtare e Shoqatës Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), [anëtarësimi iu pezullua në vitin 2019](#). Kjo situatë ndikoi negativisht në statusin e akreditimit të universiteteve kosovare brenda arenës evropiane të arsimit të lartë. Edhe pse nuk u bë asnjë përparim gjatë semestrit të dytë, Kosova ishte [ripranuar në ENQA me të drejta të plota brenda afatit më 14 korrik 2025](#). Ky vendim i ishte [komunikuar publikut](#) nga Agjencia e Kosovës për Akreditim. Ky hap reformues është një nga fushat e pakta ku është bërë përparim i matshëm gjatë afatit përkatës. Vlerësimi përfundimtar i Komisionit Evropian ende nuk është publikuar.

- ***Hyrja në fuqi e ligjit të ri që rregullon AAP-në (duke përfshirë qeverisjen, kurrikulat, formulën e financimit dhe rrjetin e institucioneve të AAP-së) dhe arsimin e të rriturve (AE) në përputhje me standardet evropiane-dhjetor 2025- Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Kjo reformë synon ta ripërtërijë sistemin dhe kornizën e qeverisjes së arsimit dhe aftësimin profesional (AAP) duke miratuar dhe zbatuar një kornizë legjislative të përditësuar. Kjo u bë me qëllim modernizimin e arsimit profesional dhe të të rriturve për ta përmirësuar përshtatshmërinë e tyre me tregun e punës dhe për t'i adresuar mangësitë strategjike në profesionet/zanatet në tregun e punës në Kosovë.

Për këtë qëllim, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka përgatitur një [projektligj për Arsimin dhe Aftësimin Profesional](#). Tashmë i është nënshtruar një procesi konsultimi në [platformën e konsultimit](#). Drafti ka marrë shumë komente nga qytetarët, shoqëria civile dhe madje edhe ekspertë ndërkombëtarë të arsimit. Ky nivel angazhimi tregon një pjesëmarrje relativisht të lartë. Edhe pse shumica e tyre vënë në pah mangësitë e draftit, edhe ekspertët evropianë e vlerësojnë atë pozitivisht për miratimin e legjislacionit përkatës. Fatkeqësisht, paraliza politike e vitit 2025 e ka bërë të pamundur votimin për këtë projektligj.

Qeveria e ardhshme duhet t'i trajtojë seriozisht komentet nga procesi i konsultimit dhe të paraqesë një draft që adreson shqetësimet e ngritura aty. Më pas, Kuvendi i ri duhet ta votojë ligjin që ai të hyjë në fuqi.

Qëllimi kryesor i Instrumentit për Reformë dhe Rritje është të [stimulojë rritjen ekonomike](#), me qëllim dyfishimin e PBB-së së Ballkanit Perëndimor deri në vitin 2030 dhe përgatitjen e vendeve për anëtarësim në BE. Për këtë qëllim, Mjedisi i Biznesit dhe Zhvillimi i Sektorit Privat është një nga domenet më të rëndësishme të politikave për të arritur këtë qëllim. Semestrat e mëparshëm përfshinin hapa reformash si krijimi dhe funksionalizimi i sistemit të kontrollit të ndihmës shtetërore, miratimi i ligjit për inovacionin, funksionalizimi i Këshillit Kombëtar të Inovacionit dhe Fondit të Inovacionit. Në semestrin aktual, krijimi i Agjencisë së Investimeve dhe Eksportit dhe regjistri publik i të gjitha Ndërmarrjeve Publike (NP) ishin disa nga reformat më të rëndësishme. Pamundësia e Kuvendit për të miratuar ligje në vitin 2025 e ka bërë të pamundur zbatimin e hapave të reformës ligjore, ndërsa roli kujdestar i qeverisë pengoi gjithashtu reformat ekzekutive. Prandaj, qeveria e ardhshme duhet t'i përshpejtojë seriozisht reformat.

Reformat Hapat e reformës	Afati i fundit (i paraparë)	Statusi i zbatimit	Gjetjet e Monitorit të Reformave
Përmirësimi i qeverisjes, efikasitetit dhe llogaridhënies së Ndërmarrjeve Publike (NP) për të rritur kontributin e tyre në ekonomi.			
Të sigurohet që të gjitha regjistrat e NP-ve të jenë publike dhe të përditësuara, duke përfshirë informatat mbi pronësinë. 100% e NP-ve kanë krijuar një komitet të pavarur auditimi për t'i adresuar gjetjet nga auditimet e brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë gjetjet e menaxhimit të riskut fiskal. Njësia përgjegjëse për monitorimin e NP-ve si mekanizëm monitorimi kërkon një raport mbi eliminimin e gjetjeve të auditorit dhe gjetjeve të menaxhimit të riskut fiskal brenda afatit të caktuar nga Bordi i Drejtorëve, duke analizuar dhe kërkuar llogaridhënie bazuar në rekomandimet e auditimit dhe elementët e riskut fiskal.	Dhjetor 2025	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në dhjetor 2026	Ministria e Ekonomisë ka publikuar një regjistër, i cili përfshin të gjitha NP-të në nivel qendror. Megjithatë, të dhënat duhet të përditësohen.
Politikat e konkurrencës / Ndihma shtetërore			
Agjencia e Investimeve dhe Eksportit dhe Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve janë themeluar dhe plotësisht funksionale]	Dhjetor 2025	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në dhjetor 2026	Qeveria kishte planifikuar prej kohësh krijimin e një agjencie të orientuar drejt eksportit dhe vetëm kohët e fundit publikoi rregulloren e themelimit. Kjo është gjithashtu e buxhetuar në buxhetin e vitit 2026.
Themelohet Komisioni i Ndihmës Shtetërore	Dhjetor 2024	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në dhjetor 2026	Anëtarët e Komisionit të Ndihmës Shtetërore duhet të votohen në Kuvend, gjë që nuk u bë për shkak të jostabilitetit politik.

Sistemi i kontrollit të ndihmës shtetërore bëhet funksional	Qershor 2025	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në qershor 2025	Sistemi i kontrollit të ndihmës shtetërore mund të vihet në funksion vetëm pas krijimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, i cili i nënshtrohet votimit në kuvend.
Miratimi i ligjit për inovacionin dhe ndërmarrësinë	Dhjetor 2024	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në dhjetor 2026	Kuvendi nuk mundi ta miratonte ligjin për shkak të jostabilitetit politik
Këshilli Kombëtar i Inovacionit dhe Fondi i Inovacionit themelohen dhe bëhen plotësisht funksionalë.	Qershor 2025	Vlerësimi i KE-së në pritje – Afati deri në qershor 2025	Themelimi i Këshillit varet nga miratimi paraprak i Ligjit për Inovacionin dhe Ndërmarrësinë.

PËRMIRËSIMI I QEVERISJES, EFIKASITETIT DHE LLOGARIDHËNIES SË NDËRMARRJEVE PUBLIKE (NP) PËR TË RRITUR KONTRIBUTIN E TYRE NË EKONOMI

- Të sigurohet që të gjitha regjistrat e NP-ve të jenë publike dhe të përditësuara, duke përfshirë informatat mbi pronësinë. 100% e NP-ve kanë krijuar një komitet të pavarur auditimi për t'i adresuar gjetjet nga auditimet e brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë gjetjet e menaxhimit të riskut fiskal. Njësia përgjegjëse për monitorimin e NP-ve si mekanizëm monitorimi kërkon një raport mbi eliminimin e gjetjeve të auditorit dhe gjetjeve të menaxhimit të riskut fiskal brenda afatit të caktuar nga Bordi i Drejtorëve, duke analizuar dhe kërkuar llogaridhënie bazuar në rekomandimet e auditimit dhe elementët e riskut fiskal.– Dhjetor 2025 - Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Kjo reformë synon ta forcojë transparencën institucionale dhe llogaridhënien publike në administrimin e Ndërmarrjeve Publike (NP) duke krijuar një regjistër efektiv që përfshin të gjitha NP-të në Kosovë. Përveç kësaj, ajo parashikon publikimin e raporteve të auditimit dhe adresimin e tyre për të siguruar performancën financiare të këtyre kompanive.

Është arritur progres i caktuar në këtë hap të reformës, pasi Ministria e Ekonomisë (ME) ka lëshuar një [regjistër online](#) të ndërmarrjeve publike në nivel qendror. Megjithatë, ky regjistër ka informacion në lidhje me 10 NP-të më të mëdha në vend që kanë gjithashtu mandat në nivel qendror. Një tjetër [regjistër online nga Ministria e Ekonomisë për kompanitë rajonale të ujit dhe ujitjes](#) është gjithashtu i qasshëm për publikun, duke e çuar totalin në 17 NP që janë pjesë e një regjistri publik. Kjo është në përputhje me [Ligjin për Ndërmarrjet Publike](#), pasi ia delegon menaxhimin e NP-ve lokale komunave.

Sa i përket komiteteve të pavarura të auditimit, Ministria e Ekonomisë i është përgjigjur një kërkesë për informata, duke sqaruar se të gjitha NP-të me Bord Drejtorësh funksional kanë emëruar komisione të tilla. Autoritetet qeveritare duhet të sigurohen që të gjitha NP-të të kenë borde funksionale me anëtarë të mjaftueshëm për vendimmarrje për të siguruar vendimmarrje të duhur, dhe më pas të vazhdojnë me krijimin e komisioneve të auditimit në NP-të e mbetura. Së fundmi, NP-të raportojnë rregullisht në ME mbi performancën e tyre financiare. Nëse ME zbulon rrezik të mundshëm, raporti i përcillet Ministrisë së Financave për veprim.

Në të ardhmen, qeveria duhet ta përditësojë regjistrin e Ndërmarrjeve Publike për të ofruar informacion të saktë dhe të përditësuar mbi pronësinë dhe menaxhimin e NP-ve. Për më tepër, të gjitha NP-të duhet të kenë borde funksionale për të emëruar komisione auditimi për t'i monitoruar aktivitetet financiare. Së fundmi, mekanizmi për ndjekjen e gjetjeve të auditimit ka nevojë për përmirësim të mëtijshëm nga ME për të identifikuar më mirë rreziqet e mundshme dhe për të parandaluar rritjen e tyre.

TË LEHTËSOHEN INVESTIMET NË SEKTORIN PRIVAT DHE TË PËRMIRËSOHEN MEKANIZMAT PËR TË TËRHEQUR INVESTIME TË HUAJA DIREKTE (IHD) NË SEKTORËT STRATEGJIKË, DUKE NXITUR MIRATIMIN E PRODUKTEVE, SHËRBIMEVE DHE INOVACIONIT ME VLERË TË SHTUAR

- ***Komisioni i Ndhmës Shtetërore i themeluar - Dhjetor 2024 - Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Kosova ka [ligj që e rregullon ndihmën shtetërore](#), i cili mandaton krijimin e një Komisioni të Ndhmës Shtetërore (KNSH) për t'i trajtuar aplikimet për ndihmë shtetërore. Megjithatë, ai ka qenë jofunksional që nga viti 2022 dhe ka nevojë për anëtarë të rinj që të votohen nga Kuvendi për t'u bërë përsëri funksional. Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e vitit 2025 u kalua pa Kuvend funksional, asnjë anëtar i ri nuk mund të votohej.

Për ta zbatuar plotësisht këtë hap reformues, Kuvendi duhet të votojë për anëtarët e rinj të KNSH-së në mënyrë që të konsiderohet i themeluar dhe të ketë përsëri një kuorum vendimmarrës. Përveç kësaj, ligji ekzistues për ndihmën shtetërore duhet të ndryshohet dhe stafi duhet të ndjekë trajnime të specializuara për të përfituar nga njohuritë më të fundit të BE-së mbi këtë temë. Legjislatura e sapokrijuar duhet të zgjedhë anëtarë të rinj në Komision për të përfunduar hapin e parë në riorganizimin e institucionit. Përveç kësaj, Komisioni duhet të miratojë rregulloren e vet të procedurës për të krijuar sistemin për sqarimin e procedurave të aplikimit dhe marrjes së ndihmës shtetërore.

- ***Sistemi i kontrollit të ndihmës shtetërore bëhet funksional - qershor 2025 - Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Parakushti për funksionalizimin e sistemit të kontrollit të ndihmës shtetërore është zgjedhja e një organi të ri të Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Meqenëse Komisioni nuk u zgjodh, sistemi nuk mundi të funksionalizohej. Funksionalizimi i plotë i sistemit të ndihmës shtetërore do të kërkojë ndryshimin e [Ligjit për Ndihmën Shtetërore](#) duke e plotësuar atë me akte nënligjore që rregullojnë mekanizmin e shqyrtimit. Përveç kësaj, KNSH duhet të ketë staf të plotë dhe me transparencë. Ky staf duhet t'i nënshtrohet trajnimit mbi legjislacionin më të fundit të BE-së mbi këtë temë. Dhe në fund, sistemi duhet t'i publikojë vendimet e veta në një regjistër publik për të siguruar transparencë të plotë dhe totale.

- ***Agjencia e Investimeve dhe Eksportit dhe Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të themeluara dhe plotësisht funksionale- Dhjetor 2025 - Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Qeveria e Kosovës ka kohë që synon të krijojë një Agjenci për Investime dhe Eksport. Baza ligjore për krijimin e kësaj agjencie është [Ligji për Investimet Strategjike](#). Kohët e fundit, Zyra e Kryeministrit ka publikuar [Rregulloren e Brendshme](#) të organizatës që është procedura e themelimit dhe përcakton organet dhe mandatin e saj. Përveç kësaj, një buxhet institucional është ndarë në [buxhetin e vitit 2026](#).

Pasi të themelohet agjencia, ajo duhet të funksionalizohet me stafin e duhur, i cili duhet të rekrutohet përmes një procesi të bazuar në merita. Duke filluar nga drejtori ekzekutiv, ekzekutivi duhet ta pajisë institucionin e ri me personel kompetent. Përveç kësaj, duhet të ndahen fonde të mjaftueshme për t'i mundësuar institucionit të përmbushë mandatin e vet. Buxheti i vitit 2026 ndan më pak se 800 mijë euro, një shifër që parashikohet të ulet në vitet në vijim. Qeveria duhet të rrisë ndjeshëm financimin aktual për të arritur rezultatet e pritura.

MBËSHETJA E KRIJIMIT DHE ZGJERIMIT TË BIZNESEVE TË REJA DHE NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME TË SPECIALIZUARA NË TIK DHE EKONOMINË E GJELBËR DHE QARKORE, SI DHE PËRVETËSIMIN E TEKNOLOGJIVE TË GJELBRA, PËRMES FONDIT TË INOVACIONIT DHE INKUBATORËVE TË BIZNESIT

- ***Miratimi i Ligjit për Inovacionin dhe Ndërmarrësinë - Dhjetor 2024 - Vlerësimi i KE-së në pritje:***

Ky hap reformues synon të krijojë bazën ligjore për promovimin e inovacionit dhe sipërmarrjes tek të rinjtë e Kosovës. Për këtë qëllim, do të hartohet një ligj i ri në këtë fushë dhe do t'i nënshtrohet një procesi konsultimi. Ky draft duhet të përfshijë Rregulloret e BE-së mbi Ekoetiketën dhe Ekodizajnin për të siguruar që teknologjitë e gjelbra të marrin mbështetje të mjaftueshme dhe një kornizë të qartë rregullative.

Aktualisht, Kosova nuk ka ligj që të ofrojë mbështetje për inovacionin dhe ndërmarrësinë. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka përgatitur një [projektligj](#) që ka kaluar në [konsultime publike](#). Megjithatë, kriza politike që karakterizoi vitin 2025 e ka bërë të pamundur miratimin e tij në Kuvend. Kuvendi i sapozgjedhur duhet ta votojë ligjin për ta futur në fuqi sa më shpejt që është e mundur, pasi e gjithë puna burokratike për përgatitjen e këtij ligji është përfunduar.

- ***Këshilli Kombëtar i Inovacionit dhe Fondi i Inovacionit themelohen dhe janë plotësisht funksionale - qershor 2025 - Vlerësimi i KE-së është në pritje:***

Agjenda e Reformave parashikon krijimin e një Këshilli Kombëtar të Inovacionit dhe një Fondi të Inovacionit për të ofruar mbështetje në nivele politikash dhe financiare për ndërmarrësit. Këto dy institucione mund ta fillojnë punën vetëm pas miratimit të Ligjit për Inovacionin dhe Ndërmarrësinë. Shqetësuese është se, ndryshe nga Agjencia e Investimeve dhe Eksportit, nuk ka ndarje buxhetore për Këshillin dhe Fondin në buxhetin e vitit 2026. Kuvendi i sapozgjedhur duhet ta miratojë një ligj për t'i filluar procedurat për krijimin e këtyre dy institucioneve. Themelimi i Fondit varet gjithashtu nga një vlerësim paraprak financiar që do të kryhet nga qeveria. Ka nevojë për rregullore të qarta të brendshme dhe thirrje të hapura dhe publike për mbështetje.

